



INTEGRIMI



BOTIM I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 20/10, Tel.: 04 270 413 Fax: 042 270412/26/ www.integrimi.al



E shtunë, 31 gusht 2019

Viti XIII i botimit - Nr. 3522
ÇMIMI 20 LEKË / 1 EURO

E përditshme politike

TRADITA VIJON / ENDRIT BRAIMILLARI

Kampi i LRI promovon solidaritetin, frymën e bashkëpunimit dhe energjinë pozitive

FAQE 3

Lëvizja Rinore për Integrim çdo ditë e më shumë forcohet dhe rritet në përgjegjësi përballë angazhimit për t'i shërbyer rinisë. Lëvizja Socialiste për Integrim ka mirësi, ka solidaritet, pozitivitet

PETRIT VASILI

Gratë e hallit politik të Edi Ramës!



Edi Rama është në hall dhe në funksion të këtij halli thërret në ndihmë gratë... Si askush në Shqipërinë politike, Edi Rama është dhe do të mbetet shpërdoruesi më i neveritshëm i simbolikës së gruas dhe krijimit të një raporti anormal mes saj dhe shoqërisë. Pjellë e një mentaliteti arkaik, që gruan e sheh si send, si instrument pa krenari, që bindet e nënshtrohet deri në kufijtë e poshtërimit, kjo është gruaja për Edi Ramën. Krijimi i mentalitetit të zgjedhjeve seksuale, pra emërohesh se je grua dhe jo se je e aftë është dëmi dhe armiqtësia më e ligë...

FAQE 2



INTERVISTA PËR MEDIAN ITALIANE 'IL GIORNALE.IT'

FAQE 5

Ilir Meta: Zgjedhjet e qershorit nuk ishin as kushtetuese, as ligjore dhe as legjitime

PETRIT VASILI

Gratë e hallit politik të Edi Ramës!

Edi Rama është në hall dhe në funksion të këtij halli thërret në ndihmë gratë... Si askush në Shqipërinë politike, Edi Rama është dhe do të mbetet shpërdoruesi më i neveritshëm i simbolikës së gruas dhe krijimit të një raporti anormal mes saj dhe shoqërisë. Pjellë e një mentaliteti arkaik, që gruan e sheh si send, si instrument pa krenari, që bindet e nënshtrohet deri në kufijtë e

poshtëritimit, kjo është gruaja për Edi Ramën. Krijimi i mentalitetit të zgjedhjeve seksuale, pra emërohesh se je grua dhe jo se je e aftë është dëmi dhe armiqësia më e ligë, që Edi Rama ka krijuar ndaj grave. Gra që i ka përdorur deri në postet më të larta të qeverisë dhe më pas të flakura e të harruara në një cep të haremit të politikës për shkak të konsumit e plakjes, ky ka qenë fati i mjaft grave

të promovuara artificialisht e pacipësisht nga Rama. Gruaja që i shërben Ramës tashmë ka një tërësi cilësish njëra më e pavlerë se tjetra, përveç njëres që është shikimi në sy dhe besnikëria poshtëruese ndaj tij. Gratë shqiptare kanë luftuar e luftojnë denjësisht një betejë të madhe atë të barazisë gjinore dinjitoze dhe të bazuar në meritë e kurrësi në blerje të personalitetit e moralit. Sot fushata “do heqim

burrat se Edi Rama do gra” është thjesht implementimi i perversitetit psikik për qëllime politike kriminale të kontrollit të pushtetit kundër ligjit dhe interesave të qytetarëve. Është i dhimbshëm përdorimi e shpërdorimi i grave për skenarë të tillë të ulëta. Sot asnjë grua në Shqipëri nuk mund dhe nuk duhet të ndihet mirë. Kjo që po ndodh me Edi Ramën dhe përdorimin e grave prej tij është antiideali i tyre,

nuk është kjo gruaja shqiptare, që ka qenë e mbetet shtyllë pozitive në shoqëri e familje, por thjesht janë gratë e hallit politik të Edi Ramës. Çdo zgjedhje e tillë e grave e pështirë moralisht dhe kriminale shtetërisht duhet refuzuar e stigmatizuar me çdo mjet e mënyrë. Ky kapo tribuje kriminale afrikane që qeveris vendin duhet të kërkojë toka e vende të tjera sepse Shqipëria e grave dinjitoze nuk e pranon atë.



PETRIT VASILI

Drejtorët në Shkodër, si kastravecë në duart e shkollëpakut!

Kjo administratë e Edi Ramës është atje thjesht shami për të fshirë hundët dhe gjithçka tjetër të tij dhe s'ka asnjë lidhje me shërbimin ndaj qytetarëve

Drejtorët e Edi Ramës hiqen e vihen ose thënë ndryshe ngulen e shkulen si kastravecë nga shkollëpakut. Se janë ata fajtorët që zgjedh Edi Rama kandidatë për faqe të zezë si Valdrin Pjetri. Drejtorët janë pra thjesht ushqim për midenë politike dhe për damllanë psikopatike të Edi Ramës

Pas serisë së dorëheqjeve të drejtorëve në Qarkun e Shkodrës, nën presionin e Kryeministrit Edi Rama, sjellin reagimin edhe të nënkryetarit të LSI, Petrit Vasili. Përmes një reagimi në Facebook, Vasili shkruan ndër të tjera se, “drejtorët e Edi Ramës hiqen e vihen, ose thënë ndryshe ngulen e shkulen si kastravecë nga shkollëpakut”. “Drejtorët janë pra thjesht

ushqim për midenë politike dhe për damllanë psikopatike të Edi Ramës”, shkruan Vasili.

Reagimi i plotë i Petrit Vasilit

Drejtorët në Shkodër si kastravecë në duart e shkollëpakut! Drejtorët e Edi Ramës hiqen e vihen ose thënë ndryshe ngulen e shkulen si kastravecë nga shkollëpakut. Se janë ata fajtorët që zgjedh Edi

Rama kandidatë për faqe të zezë si Valdrin Pjetri. Drejtorët janë pra thjesht ushqim për midenë politike dhe për damllanë psikopatike të Edi Ramës. Çfarë administratë e pacipë është kjo? Ku e ka pavarësinë nga politika? Po portalet e famshme të punësimit që patakën dynjanë ku përfunduan? Apo administrata është thjesht zorrë qorre e Edi Ramës? Ku janë kriter-

et e punësimit? Ku është zyra e partisë apo ligji dhe kriteret që punësojnë njerëzit? Objektivat në punë dhe shërbimi ndaj qytetarëve janë kriteri apo votat e mbledhura? Ky demagog i shpëlarë që moçalisht vegjeton si Kryeministër qelbi dynjanë me propagandë për gjoja administratën e “ndritur” që do të ngrinte, pasi të merrte timonin

dhe tepsinë. E pamë administratën e diskredituar, të korruptuar e të përcudnuar të timonit dhe tepsisë së Kryeministrit. Kjo administratë e Edi Ramës është atje thjesht shami për të fshirë hundët dhe gjithçka tjetër të tij dhe s'ka asnjë lidhje me shërbimin ndaj qytetarëve. Shkodra ishte shembulli më i qartë se si drejtorët shndërrohen në kastravecë.

TRADITA VIJON

Braimllari: Kampi i LRI promovon solidaritetin, frymën e bashkëpunimit dhe energjinë pozitive

Lëvizja Rinore për Integrim çdo ditë e më shumë forcohet dhe rritet në përgjegjësi përballë angazhimit për t'i shërbyer rinisë. Lëvizja Socialiste për Integrim ka mirësi, ka solidaritet, pozitivitet

Ish-deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Endrit Braimllari, ka falënderuar Floida Kërpaçin dhe gjithë Lëvizjen Rinore për Integrim për aktivitetin fantastik që kanë realizuar në jug të vendit. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Braimllari shton se LRI e vijon traditën fantastike, duke promovuar solidaritetin, frymën e bashkëpunimit dhe energjinë pozitive.

Postimi i Endrit Braimllarit

Faleminderit Floida dhe ekipit të LRI-së për surprizën emocionuese. Tradita vazhdon brenda LRI-së. Lëvizja Rinore për Integrim çdo ditë e më shumë forcohet dhe rritet në përgjegjësi përballë angazhimit për t'i shërbyer rinisë. Përgjegjësia e gjithsecilit nga ne për shokët jo vetëm të forumit, por në të gjithë shoqërinë u kultivua brenda Lëvizjes Socialiste për Integrim. LSI kultivoi tek ne përgjegjësinë, solidaritetin, frymën e bashkëpunimit dhe energjinë pozitive. Lëvizja Socialiste për Integrim ka mirësi, ka solidaritet, pozitivitet. Kjo mishërohet më së miri tek organizata me e mirë dhe me e fortë rinore, te Lëvizja Rinore për Integrim. Tek ky ekip i fantastik dhe sfidues.



Lëvizja Socialiste për Integrim ka mirësi, ka solidaritet, pozitivitet. Kjo mishërohet më së miri tek organizata me e mirë dhe me e fortë rinore, tek Lëvizja Rinore për Integrim. Tek ky ekip i fantastik dhe sfidues

TRAJNIME, PUNË, ARGËTIM

Të rinjtë e Lëvizjes Rinore për Integrim ndriçojnë gjirin e Jalit

Aktivitetet, puna, trajnimet dhe argëtimi nuk munguan as ditën e djeshme në kampin veror të LRI-së. Kampistët u trajnuan në fusha të ndryshme nga zëvendëskryetari i Lëvizjes

Socialiste për Integrim, Luan Rama dhe ish-deputetja e Partisë Demokratike, Grida Duma. As në mbrëmje nuk mungoi entuziazmi dhe surprizat. Të pranishëm në aktivitetin e mbrëmjes ishin Kryetarja e

LSI-së, Monika Kryemadhi, zëvendëskryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Luan Rama, nënkryetarët Petrit Vasili dhe Kejdi Mehmetaj, ish-deputetja e Partisë Demokratike, Grida Duma dhe shumë të ftuar të tjerë.



NGA KAMPI I LRI NË JALË

Grida Duma: Të rinjtë do ta nxjerrin vendin nga kaosi social

Ish-deputetja demokrate, Grida Duma, i ka dhënë një mesazh të fortë të rinjve shqiptarë. E pranishme si e ftuar në kampin veror të LRI-së, Duma ka diskutuar dje me të rinjtë për situatën politike në vend. Me fjalët e ish-presidentit amerikan

Rusvelt, Duma dha këtë mesazh: "Për të dalë nga ky depresioni social, ne duhet t'i themi gjërat në mënyrë të vërtetë. Është detyra juaj të merrni përsipër përgjegjësinë për të nxjerrë këtë vend nga depresioni social, pa asnjë kompleks që jeni

më të ndryshëm, më të mirë. Nuk ka rrugë tjetër, të rinjtë duhet të jenë në pararoje. Bëhuni gati, sepse do vijë momenti kur do duhet të jeni në rresht të parë dhe duhet të jeni gati, nuk ka rrugë tjetër", tha ndër të tjera në fjalën e saj, Grida Duma.



'DEUTSCHE WELLE'

Pse të inkriminuarit vazhdojnë të hyjnë në politikë në Shqipëri?

Pastrimi i politikës nga individë me rekorde kriminale është rikthyer në çështje të nxehtë dite në Tiranë. 4 vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Dekriminalizimit të politikës duket se ai nuk i ka plotësuar pritshmëritë. Dy kryetarë socialistë bashkish, në Bashkinë e Shkodrës dhe atë të Vorës, të zgjedhur 2 muaj më parë në Lokalet 2019, sipas opozitës, janë me rekorde kriminale. Të dy i kanë fshehur ato në plotësimin e formularëve përkatës në zbatim të ligjit të dekriminalizimit. Njëri, Valdrin Pjetri në Shkodër dha dorëheqjen, kur opozita publikoi dokumente që vërtetonin dënimin e tij në Itali për shitje droge, në vitin 2003, kur ishte student. Tjetri, Agim Kajmaku, në Vorë, akuzohet nga opozita se po në vitin 2003, u arrestua në Greqi për përdorim dhe shpërndarje kartemonedhash të falsifikuara. Ai u arratis nga burgu pa kryer dënimin, erdhi në Shqipëri, ndryshoi identitetin dhe u bë biznesmen i pasur. Sipas opozitës, Kajmaku kërkohet edhe sot e kësaj dite nga drejtësia e Greqisë. Të enjten, (29.08.2019) opozita publikoi dokumente që, sipas saj, vërtetojnë sa më lart për Agim Kajmakun. Por ai i quan akuzat e opozitës "shpifje, sulm politik" dhe vazhdon të jetë kryetar i Bashkisë së Vorës. Dorëheqja ose jo e Agim Kajmakut, do të varret nga rezultatet e hetimit, që me kërkesën e opozitës po kryen për atë Prokuroria e Përgjithshme.

Të inkriminuarit në politikë – prurje nga biznesi

Dukuria e futjes në politikë të personave me rekorde kriminale u shfaq në Shqipëri për herë të parë në zgjedhjet parlamentare 2009, të fituara atëherë nga Partia Demokratike (PD). Sistemi zgjedhor i centralizuar, që u përdor së pari në ato zgjedhje, bëri të mun-



dur që të hynin në parlament persona me rekorde kriminale, gjë që vijoi edhe në zgjedhjet parlamentare 2013, të fituara nga Partia Socialiste (PS). Të dyja palët brenda një dekade forcuan modelin politik të imunitetit, paprekshmërisë që individë/biznesmenë të pasur me rekorde kriminale mund fitojnë përmes hyrjes në politikë. Prof. Afrim Krasniqi, studiues, autor i librit "Dekriminalizimi – Gjendja, Problematikat dhe Pritshmëritë", botuar me mbështetjen e fondacionit gjerman "Konrad Adenauer", thotë për 'Deutsche Wellen', se të gjitha rastet e individëve të inkriminuar vijnë nga biznesi dhe jo politika. "Të gjithë të inkriminuarit e deritanishëm, deputetë në Parlament apo kryetarë bashkish, janë prurje aksidentale nga biznesi, lobi-mi dhe financimi elektoral. Asnjë prej tyre nuk është zgjedhur nga partitë politike përmes garës por janë diktuar nga lart, nga drejtuesit e partive".

Partitë – pa vullnet politik

Kryetari i PS, Kryeministri

Rama, tha ditët e fundit se Valdrin Pjetri, 'doli mollë e kalbur', për të cilën PS nuk mban përgjegjësi, por reagon duke e flakur atë. Rasti i flakjes së Valdrin Pjetrit shfaqet deri tani si i vetmi në spektrin politik të Tiranës. "As deputetët që humbën mandatin për shkak të rekordeve kriminale, as ndonjë prej tyre që sot ndodhet në burg, as ish-kryetarët e bashkive të dorëhequr apo në listën e zezë të SHBA nuk janë përjashtuar nga partia e vet politike. Përkundrazi, ata janë deleguar në bazë dhe vijnë në jenë aktivë në fushata elektorale, të ushtrojnë "de facto" më shumë ndikim në zonat e tyre lokale sesa ai që ushtronin kur ishin në parlament, apo në vendimmarrjen politike. Ata vijnë në jenë përfitues privilegjesh si ish-deputetë, ish-kryetarë bashkish dhe në ndonjë rast edhe të rikandidojnë në zgjedhjet parlamentare apo lokale" thotë për DW, Prof. Krasniqi. Ai mendon se kjo situatë i ka rrënjët financimi i partive politike nga burime private "që kanë aktivitete kriminale dhe korrupsion". Dy rastet

e fundit kanë nxjerrë në dritë mangësitë e ligjit të dekriminalizimit që bëri të mundur largimet daljen „de jure” nga politika por jo „de facto” të inkriminuarve, në 4 vitet e fundit të zbatimit të tij.

Ligj joefikas, institucione të dështuara

Ligji i dekriminalizimit të politikës hyri në fuqi në vitin 2015. Sistemi zgjedhor i centralizuar, me të cilin u zhvilluan për herë të parë zgjedhjet parlamentare 2009 hapi dritën e gjelbër për hyrjen në Parlament të personave të pasur, me rekorde kriminale. Dukuria vijoi edhe në zgjedhjet e vitit 2013, të fituara nga PS dhe u bë shqetësim i opozitës së kryesuar nga PD, që mori nismën për ligjin në fjalë. Ligji, i miratuar nga dy palët ndalon "çdo individ, që në të kaluarën është dënuar nga gjykatat vendase apo të huaja, për t'u zgjedhur apo emëruar në funksione publike". Pas hyrjes së tij në fuqi, pati largime dhe dorëheqje të figurave publike me rekorde kriminale nga PD dhe PS. Por rastet e freskëta të Shko-

drës dhe Vorës tregojnë se ky ligj nuk po plotëson pritshmëritë për çrrënjësimin e hyrjes në politikë të inkriminuarve. "Ligji ka mangësi. Ai penalizon ata që plotësojnë formularin e dekriminalizimit, në të cilin ka elementë kërkues që nuk janë në ligj. Rreth 40% e figurave publike që janë larguar për shkak të rekordeve kriminale, janë penalizuar jo nga ligji, por nga formulari," thotë për DW, Prof. Krasniqi. Rastet Pjetri dhe Kajmaku tregojnë edhe dështimin e institucioneve të verifikimit, përfshirë edhe Shërbimet Sekrete, aq më tepër kur është fjala për persona të pasur, që hyjnë në politikë nga biznesi.

SPAK – faktor kyç për ndryshim

Rastet e dy kryebashkiakëve socialistë, njëri i dorëhequr dhe tjetri në pritje të rezultatit të hetimeve nga Prokuroria e Përgjithshme, kanë ngjallur debat në PS. Kryetari i saj dhe kreu i qeverisë Rama flet për përgjegjësi të individit dhe jo të partisë. Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, kundërshtoi

Ramën, në mes të kësaj jave (28.08) kur në mbledhjen e Kryesisë së PS tha: "PS ka përgjegjësi të madhe në shfaqjen e fenomenit të rikthimit në PS të njerëzve me të kaluar të dyshimtë dhe se duhet një reformë politike brenda partive politike, për të sjellë një kulturë të re politike." Prof. Krasniqi thotë për DW se "reformimi i partive politike duhet t'i detyrojë ato, përmes ligjit të partive, të bëjnë zgjedhje të brendshme konkurruese, të jenë transparente dhe të mbajnë përgjegjësi. "Krahas reformimit të partive, duhet reforma e sistemit zgjedhor për t'i dhënë fund modelit politik "i forti blen vota për të blerë më pas pushtetin". Ligji duhet të detyrojë partitë të bëjnë transparente burimet e tyre financiare dhe të çdo kandidati. Një faktor kyç pritet të jetë SPAK, që do të ushtrojë presion të vazhdueshëm ndaj kryetarëve të partive për ta bërë të pamundur hyrjen në politikë të individëve me rekorde kriminale, por me fuqi të mëdha financiare dhe lobuese në politikë", thekson Prof. Krasniqi për DW.

INTERVISTA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR MEDIAN ITALIANE 'IL GIORNALE.IT'

Illir Meta: Zgjedhjet e qershorit nuk ishin as kushtetuese, as ligjore, as legjitime

Zgjedhjet e qershorit nuk ishin as kushtetuese, as ligjore, as legjitime, vetëm Gjykata Kushtetuese mund të kundërshtojë dekretin e Presidentit. Është për të ardhur keq, që deri më sot veprimtaria e gjykatës është pezulluar me vullnetin e Ramës

Presidenti i Republikës, z. Illir Meta, ka folur së fundmi në një intervistë për median italiane 'Ilgiornale.it'. "Illir Meta po përjeton momentin më të ndërlikuar që kur u zgjodh President në vitin 2017, përplasja institucionale me Kryeministrin Edi Rama arriti kulmin në qershor, kur me gjithë vendimin e Presidentit për të shtyrë zgjedhjet administrative me një dekret, qeveria ka vendosur t'i kryejë ato pa partitë e opozitës, duke nxitur protesta të shumta dhe vetëm 23% e votuesve shkuan në votime". Kështu e nis shkrimin e saj media italiane "Ilgiornale.it", për të cilën Presidenti shqiptar ka dhënë një intervistë gjatë kohës që ishte me pushime te Gjiri i Lalzit. "Nëse nuk do të kisha nxjerrë dekretin për të shtyrë zgjedhjet më 13 tetor, një datë jo rastësore, sepse procesi i pranimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore në Bashkimin Evropian diskutohet më 18 tetor, do të kishte qenë e pashmangshme një përplasje mes dy fraksioneve politike. Ndërsa unë vepra sipas Kushtetutës, përgjegjësia e Kryeministrit ishte që ai nuk e kuptonte që zgjedhjet e mbajtura në këtë mënyrë ishin problem për negociatat. Zgjedhjet e qershorit nuk ishin as kushtetuese, as ligjore, as legjitime", u shpreh ndër të tjera Presidenti Meta. I pyetur për përgjimet e nxjerra nga gazeta gjermane "Bild" para disa muajsh, Meta është shprehur: "Ishte e papranueshme që vitet e fundit nuk janë bërë hetime të thella për këto ngjarje, është një nga rastet më të rënda të funksionimit të shtetit të së drejtës, zgjedhjet e rregullta janë zgjidhja e këtyre problemeve".

President, pas vendimit tuaj për të shtyrë zgjedhjet lokale më 30 qershor dhe zgjedhjen e qeverisë për t'i realizuar ato, si kanë ndryshuar marrëdhëniet midis jush dhe Kryeministrit Edi Rama?

Nëse nuk do të kisha nxjerrë dekretin për të shtyrë zgjedhjet më 13 tetor, një datë jo e rastësishme, sepse më 18 tetor do të vendoset nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave



të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, do të ishte e pashmangshme një përplasje mes dy kampeve politike. Në një kohë që unë vepra sipas Kushtetutës, përgjegjësia e Kryeministrit ishte që ai nuk po e kuptonte se zgjedhjet e zhvilluara në këtë mënyrë ishin problem për negociatat me BE-në. Zgjedhjet e qershorit nuk ishin as kushtetuese, as ligjore, as legjitime, vetëm Gjykata Kushtetuese mund të kundërshtojë dekretin e Presidentit. Është për të ardhur keq që deri më sot veprimtaria e gjykatës është pezulluar me vullnetin e Ramës. Për të kuptuar parregullsinë e këtyre zgjedhjeve, mjafton të mendosh faktin se në të gjitha 61 bashkitë ku u zhvilluan votime, fituan socialistët sepse nuk kishin asnjë kundërshtar si gjatë regjimit komunist.

E keni seriozisht?

Do t'ju them më shumë: jo vetëm

që partia e Kryeministrit ka zgjedhur të gjithë kryetarët e bashkive, por edhe të gjithë anëtarët e këshillave bashkiakë, përfshirë edhe qytetin e Tiranës. Rezultati i pjesëmarrjes u shpall pas më shumë se njëzet ditëve dhe ishte zyrtarisht 23%, por në të vërtetë ishte më i ulët.

Disa javë para zgjedhjeve në 30 qershor, e përjavshmja gjermane "BILD" publikoi një seri përgjimesh për politikanët e Partisë Socialiste, zyrtarë të Policisë dhe elementë të krimit të organizuar, gjë që tregon se shumë marrëveshje ishin rezultat i shkëmbimit të votave, duke nxjerrë zbuluar një sistem korupsioni shqetësues. Çfarë mendoni për këtë histori?

Është e papranueshme që vitet e fundit nuk është bërë asnjë hetim i thelluar për këto ngjarje. Është një nga rastet më të rënda të funksionimit të shtetit të së drejtës, zhvillimi i zgjed-

hjeve të rregullta është zgjidhja kryesore për krizën aktuale. Nevojiten masa të forta për të zhdukur problemin e drogës, fitimet që vijnë nga trafiku i drogës janë shumë më të larta në Shqipëri sa i përket dimensioneve të ekonomisë sonë sesa në vendet më të mëdha si Italia apo Gjermania.

Kanë ngjallur debat edhe disa deklarata tuaja ku denonconit influencën e Sorosit në Shqipëri. Cila është marrëdhënia midis "Shoqërisë së Hapur" dhe reformës së sistemit të drejtësisë shqiptar? Në çmënyrë ka ndikuar Soros?

Ne jemi një komb i vogël dhe duhet të jemi të kujdesshëm në një epokë globalizimi, si kjo aktualja, për të ruajtur vlerat që qëndrojnë në themelet e Shqipërisë, duke nisur nga identiteti ynë. Duhet të mbrojmë interesat tona kombëtare pa përfunduar në duart e lo-

jtareve ndërkombëtarë privatë. Unë nuk jam një populist, por një realist që dëshiron të mbrojtë Shqipërinë.

Cili është statusi i procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian?

Unë besoj se anëtarësimi ynë në Bashkimin Evropian është i nevojshëm, megjithëse progresi i bërë deri më sot nuk është shumë inkurajues. Ajo që më shqetëson më shumë është emigrimi me ritme të larta i të rinjve, është e nevojshme të krijohen perspektivat në të ardhmen për të rinjtë që vendosin të largohen nga Shqipëria. Çdo vit dhjetëra mijëra njerëz largohen nga vendi ynë dhe nëse vazhdojmë kështu, do të përballemi me shpopullimin që ngjason me atë të viteve '90-të pas rënies së komunizmit. Nëse asokohe kjo gjë ishte e kuptueshme, sot nuk është më kështu, sepse duhen përgjigje efikase nga politika.

GENTIAN ÇALA

FRYN ERË NGA VERIU

Kam disa kohë që mendoj se çështja e pazgjidhur ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, pra Kosova, influencon shumëçka në Ballkan. Kjo ndikon edhe në krizën politike në Shqipëri. Unë nuk jam dikush nga ata që u pëlqejnë teoritë konspirative, as nuk jam nga ata që për çdo problem drejtojnë gishtin jashtë Shqipërisë, por do të përpiqem të shpjegoj se ka një lidhje të fortë ndërmjet këtyre çështjeve.

Era fryn fort nga veriu i vendit tonë. Trazimi politik i situatës ka aktorë kryesor Edi Ramën, kurse mbështetja e disa qarqeve ndërkombëtare ndaj tij ndërlidhet me interesa në Kosovë, gjeostrategjikë apo influence, që vijnë nga disa drejtime Rusia, Turqia, BE, Britania

e Madhe dhe SHBA. Në këtë shah diplomacie dhe interesash, Rama duket aktori më i përshtatshëm për qarqet jo domosdoshmërisht antishqiptare, por që me qëndrimet e tyre janë të tilla.

Ai ishte i pozicionuar ndaj një plani që ribënte kufijtë e Kosovës, një pazar i qartë antishqiptar, destabilizues dhe i rrezikshëm. Çfarë e bindi Ramën që kjo është zgjidhja?! Jo, nuk e bindi asgjë, por përlllogaritë se cili nga qëndrimet i zgjaste atij pushtetin dhe i mbronte krahët. Ajo që nuk dimë, është pjesa nën ujë e ajsbergut të së vërtetës, ndaj na lind e drejta të bëjmë hipoteza bazuar në ato që janë bërë publike. Rama me trille fitoi pushtetin në Shqipëri dhe ka gjetur një trill për mbështetje ndërkombëtare, përveç

atij të korruptimit të ndonjë diplomati të huaj.

Një zgjidhje reciproke e çështjes së Kosovës, do të shoqërohej me dobësim të pozitive të Ramës. Do ta thërrmonte koracën e tij të krijuar nga ndërkombëtarë dhe diplomatë, me interesa të caktuara. Ata po e përdorin atë, ashtu si edhe ai po mundohet të përfitojë nga kjo rrethanë. Kjo është nyja ku lidhen këto dy çështje duke pasur ndikim në krizën politike aktuale. Kushdo qoftë që do të përpiqet ta pengojë këtë sipërmarrje do të sulmohet politikisht ose do të përpiqen ti dobësojnë pozitën. Ata më të rëndësishmit, janë të parët: Haradinaj, Meta etj.

Politika me shkop dhe me karotë, ndaj liderëve në Ballkan funksion-

on dhe do të vazhdojë të përdoret, për aq kohë sa problemet mbeten pa zgjidhur dhe hijet e konfliktit janë rrotull. Rama si pazarxhi i paskrupullt vazhdon t'i kontribuojë një skeme, që nuk e dimë fijet ku i nisnin e ku i mbarojnë. Ai përdor më pas median, politikën e jashtme, gjithë strukturën propagandistike për të na bindur se dhënia e disa territoreve Serbisë, na qenkësh një mundësi për paqe.

Unë besoj se kjo nuk do të ndodhë, pasi ka ende kundërshtarë të rëndësishëm ndërkombëtarë zgjidhja e shkëmbimit të territoreve, por kjo çështje do të vazhdojë të ndikojë në politikën shqiptare ashtu si rridrita me hijet. Pjesa e pandriçuar e së cilës mbeten liderët si Rama dhe Vuçiç, populistë dhe shkurt-pamës.



HIDHET SHORTI I CHAMPIONS LEAGUE

Sërish grup ferri për Interin, probleme edhe për Juven e Chelsea-n

Grup ferri sërish për Interin në Uefa Champions League. Ashtu si një vit më parë edhe këtë herë, zikaltërit do të masin forcat me Barcelonën, por edhe me Borussia e Dortmundit dhe Slavian e Pragës

Grup ferri sërish për Interin në Uefa Champions League. Ashtu si një vit më parë, edhe këtë herë, zikaltërit do të masin forcat me Barcelonën, por edhe me Borussia e Dortmundit dhe Slavian e Pragës. Asnjë ish-interist si Wesley Sneijder fitues i Championsit në 2010-ën me zikaltërit nuk i solli fat skuadrës së Antonio Contes, që në shortin e fazës së grupeve të hedhur në Montekarlo peshkoi dy rivalë shumë të fortë, si Barça dhe Dortmundi. Edhe pse këtë herë Interi ishte në vazën e tretë, shorti nuk u tregua aspak bujar me zikaltërit që tashmë duhet të luajnë me Dortmundin për vendin e 2-të, pasi Barcelona si kokë grupi është e avantazhuar për të dalë e para. Grupi F duket ai më in-

teresanti, por në një grup të vështirë bën pjesë edhe Juventus, që u shortua ndaj Atletico së Madridit, Bayer Leverkusen dhe Lokomotivës së Moskës në grupin D. Në grupin A, ndërkohë janë gjithashtu dy superskuadra, si Paris Saint Germain dhe Real Madrid, gjithsesi dy rivalët e tjerë janë më se të kalueshëm pasi parisienët dhe Los Blancos kanë në grup edhe Club Brugge e Galatasaray-n. Në grupin B, Bayerni do të vuajë jo pak ndaj Tottenham Hotspur, Olympicosit dhe Crvena Zvezdës. Me fat Mançester City që u shortua me skuadra të tilla si Shakhtar Donetsk ashtu si një vit më parë, por edhe me Dinamon e Zagrebit e Atalantën në grupin C. Në grupin D Liverpooli do të masë forcat sërish me Napolin, por edhe Salzbur-

gun e Genk. Në grupin G bëjnë 4 skuadra të të njëjtit nivel, si Zenit, Benfica, Lion dhe Leipzig, ndërsa interesant është edhe grupi H me Chelsea, Ajaxin, Valencian dhe Lille.



Asnjë ish-interist si Wesley Sneijder fitues i Championsit në 2010-ën me zikaltërit nuk i solli fat skuadrës së Antonio Contes, që në shortin e fazës së grupeve, të hedhur në Montekarlo, peshkoi dy rivalë shumë të fortë, si Barça dhe Dortmundi

GROUP A	GROUP B
PARIS	BAYERN
REAL MADRID	TOTTENHAM
CLUB BRUGGE	OLYMPIACOS
GALATASARAY	CRVENA ZVEZDA
GROUP C	GROUP D
MAN. CITY	JUVENTUS
SHAKHTAR DONETSK	ATLÉTICO
DINAMO ZAGREB	LEVERKUSEN
ATALANTA	LOKOMOTIV MOSKVA
GROUP E	GROUP F
LIVERPOOL	BARCELONA
NAPOLI	DORTMUND
SALZBURG	INTER
GENK	SLAVIA PRAHA
GROUP G	GROUP H
ZENIT	CHELSEA
BENFICA	AJAX
LYON	VALENCIA
LEIPZIG	LOSC

E DHIMBSHME

Luis Enrique humbet vajzën 9-vjeçare!



Familja e Luis Enriques është në zi. Ish-trajneri i Barcelonës dhe Spanjës ka bërë publik lajmin tragjik për ndarjen nga jeta të vajzës së tij 9-vjeçare Ksana. Zbulohet kështu edhe shkaku se përse Luis Enrique dha dorëheqjen nga stoli i Spanjës, pak kohë më parë. Trajneri u largua nga Kombëtarja para disa muajsh, për probleme familjare, teksa vajza e tij po luftonte me një sëmundje të rëndë (osteosarkoma – tumor në kockë). “Vajza jonë ka ndërruar jetë këtë pasdite, në moshën 9-vjeçare, pas 5 muajsh luftë intensive kundër osteosarkomës. Duam të falënderojmë të gjithë mesazhet që kemi marrë këto muaj dhe i vlerësojmë. Duam të falënderojmë stafin e spitalit “San Joan de Deu and Sant Pau”, për dedikimin e tyre. Do na mungosh shumë, por ne do të kujtojmë çdo ditë të jetës sonë dhe shpresojmë që në të ardhmen të takohemi sërish. Do jesh ylli që drejton familjen tonë. Pusho e qetë Ksanita”, shkruhej në njoftimin e trajnerit spanjoll.

ZYRTARE

Franca pa dy yjet e skuadrës ndaj Shqipërisë

Shqipëria mund të buzëqeshë. Trajneri i Francës, Didier Deschamps, ka publikuar listën e futbollistëve të grumbulluar për dy sfidat e radhës kualifikuese ndaj Shqipërisë dhe Andorrës dhe ashtu siç Kante nuk do të luajnë ndaj

kuqezinjve dhe Andorrës, pasi nuk janë grumbulluar për shkaqe dëmtimi. Mungesa të tjera të rëndësishme do të jenë edhe ato të Lacazzete e Umtiti, të lënë jashtë nga trajneri Deschamps për zgjedhje teknike. Megjithatë, në fushë Franca një artilleri të rëndë edhe pa

dyshe Mbappe-Kante dhe Shqipëria e Edy Rejas duhet t'i marrë mirë masat. Vetëm 5 mesfushorë ka grumbulluar Deschamps ku spikasin, Pogba, Sissoko e Matuidi, ndërsa në sulm emrat e rëndë janë Griezmann, Giroud e Coman pa harruar Ben Yedder, Fekir e Lemar.



“TIRANA NJË QYTET NË LIBRA”

Protagoniste në ‘Festivaletteratura 2019’ në Itali

Një qytet në mes Perëndimit dhe Lindjes dhe rrugë kryesore mes ikjeve dhe ardhjeve në zemër të Mesdheut, pas errësirës së fundit të viteve 1900 dhe karvanit të gjatë, me mijëra persona që braktisnin bregun lindor të Adriatikut, Tirana sot është në qendër të një rilindjeje të gjallëruar dhe të bollshme kulturore

Një qytet në mes Perëndimit dhe Lindjes dhe rrugë kryesore mes ikjeve dhe ardhjeve në zemër të Mesdheut, pas errësirës së fundit të viteve 1900 dhe karvanit të gjatë, me mijëra persona që braktisnin bregun lindor të Adriatikut, Tirana sot është në qendër të një rilindjeje të gjallëruar dhe të bollshme kulturore. Njësoj si në letërsinë e saj, relativisht e re bashkë me arkitekturën e saj, ku shfaqen gjurmët e totalitarizmave, por edhe prania e godinave osmane, qyteteve dhe pallateve të stilit “Liberty”, reminishenca të së nesërmeve të huaja dhe ndërhyrjeve inovative të transformimeve urbane.

Tirana

Tirana, një qytet në libra, është e përzgjedhur si protagoniste në ‘Festivaletteratura 2019’, që do të zhvillohet në Mantova të Italisë nga data 4-8 shtator. Ndërkaq, një bibliotekë e përkohshme me rreth 200 vepra të autorëve shqiptarë e të huaj, ku zbulohet kryeqyteti shqiptar, është ngritur në Piazza Sordello, nën kurimin e studiuesit, eseistit, përkthyesit e

“
Tirana, një qytet në libra, është e përzgjedhur si protagoniste në ‘Festivaletteratura 2019’, që do të zhvillohet në Mantova të Italisë, nga data 4-8 shtator. Ndërkaq, një bibliotekë e përkohshme me rreth 200 vepra të autorëve shqiptarë e të huaj, ku zbulohet kryeqyteti shqiptar, është ngritur në Piazza Sordello, nën kurimin e studiuesit, eseistit, përkthyesit e pedagogut, Luca Scarlini

pedagogut, Luca Scarlini. Biblioteka e përkohshme e kuruar nga Luca Scarlini do të jetë e hapur nga data 4 deri më 8 shtator falë bashkëpunimit mes ‘Festivaletteratura’, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali dhe Rrjetit Mantovan të Bibliotekave, me mbështetje e Ministrisë shqiptare të Kulturës dhe të Bashkisë së Tiranës, synon të jetë një dritare për shkrimtarët dhe ngjarjet e një kryeqyteti, që ende së ka lënë pas të kaluarën, që

shikon drejt të ardhmes.

Guidat

Një rrugëtim i riprodhuar nga kuratori në një formë hyrjeje dhe i pasuruar me sjelljen e guidave shumë të vlefshme nga biblioteka, që në krahë të veprave më të rëndësishme të autorëve shqiptarë do të jetë edhe një rast për të zbuluar histori si ajo e Jeronim De Radës, intelektual dhe poet që themeloi në Kalabri gazetën “L’Albanese d’Italia”, duke u bërë një prej protagonistëve

të letërsisë shqiptare të shekullit XIX. Të udhëtosh njësoj si antropologia Edit Durham dhe shkrimtari Jozef Roth, që mbetën të magjepsur nga bukuria e një toke shumë pranë, e megjithatë të mistershme. Të njohësh gjuhë që edhe sot dëshmojnë një vitalitet të jashtëzakonshëm, si ajo e komunitetit arbëresh të Italisë jugore. Duke ndjekur një linjë që nisat nga mbi 160 titujt e pranishëm në bibliotekë, Luca Scarlini dhe lexuesit e “Compagnia della Lettura”

do të zhvillojnë një performancë korale në hapësirat e bukura të “Consorzio di Bonifica”, duke i dhënë zë personazheve të vërtetë dhe imagjinare, që kanë shkelur rrugët e Tiranës.

Festivali

Në festival do të festohen gjithashtu dëshmitë e shkrimtarëve të rëndësishëm shqiptarë si Fatos Kongoli, i intervistuar nga Bruno Gambarotta dhe Virgjil Muçi, protagonist i një eventit në shoqëri të

Massimo Cirri, si dhe do të ketë një lexim përrallor në “Casa del Mantegna”. Një hapësirë e gjerë do t’i jepet edhe arkitekturës në Tiranë në konferencën e Elisabetta Terragni, autore e ndërhyrjeve të rëndësishme për ruajtje dhe krijim të hapësirave muzeore, mes të cilave “Shtëpia e Gjetheve”, si dhe “Shtëpia Muze e Kadaresë”, pa harruar muzikën dhe meloditë prekëse të diasporës, që do të rigjallërohen në koncertin e këngëtares xhaz, Elina Duni.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

350 mijë dokumente me rëndësi historike mbërrijnë nga Stambolli

Rreth 350 mijë dokumente që datojnë nga shek XV-XX me rëndësi historike kombëtare kanë ardhur nga Arkivi Qendror i Stambollit në formë digjitale dhe shumë shpejt do të jepen për shfrytëzim për të gjithë historianët dhe studiuesit. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në Shqipëri ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Arkivave në Stamboll, prej së cilës ka marrë plot 350 mijë dokumente që i përkasin periudhës osmane. Drejtori i Arkivave, Ardit Bido, gjatë një deklarate për mediat u shpreh se këto dokumente hedhin dritë mbi historinë e panjohur të pushtimit osman në Shqipëri. Sipas tij, në vazhdim do



të vijnë nga Stambolli të tjera dokumente të kësaj periudhe dhe të gjithë historianët e studiuesit do të gjejnë gjithçka në arkivat shqiptare. “350 mijë dokumente kanë ardhur nga Stambolli. Dokumentet da-

tojnë nga shekulli XV-XX. Dokumentet janë me rëndësi historike. Ndërkohë, shumë shpejt do të vijnë të tjera dokumente nga Turqia. Dokumentet vijnë në kuadër të një marrëveshje bashkëpunimi

me arkivin e Stambollit”, tha Bido. “Gjatë vitit 2016 u morën rreth 5 mijë dokumente. AKSH përmban sot tërësinë e dokumenteve pas pavarësisë, por edhe tërësinë e dokumenteve gjatë periudhës osmane. Është një mori e jashtëzakonshme dokumentare, që duhet të kalojë në një proces renditjeje. Sipas parashikimeve tona, nga fundi i vitit të ardhshme do jenë gati dokumentet për shfrytëzim”, vijoi drejtori Arkivave. “Kjo bëhet për të pasur një pamje të qartë historike mbi ato gjëra që nuk ishin të qarta. Do kemi gjithë pasurinë kombëtare mbi periudhën osmane. Asnjë studiues s’do duhet të shkojë në arkiva të tjera, do t’i ketë të gjitha këtu për Shqipërinë

në periudhën osmane. Dokumentet që kanë ardhur janë të njëjta me origjinalet. Asnjë dokument i periudhës osmane nuk është sekret, por janë dokumente që nuk i dinim deri më dje. Ju takon historianëve t’i analizojnë”, deklaroi Bido. “Dokumentet kanë të bëjnë me çështje fetare, arsimore si dhe shkrimin e gjuhës shqipe. Kemi regjistra ku përfshihen qytete të rëndësishme Prizreni e Janina”, shtoi ai. “Dokumentet u përzgjedhën nga specialistët tanë që kanë shkuar në Stamboll. Në fund të procesit që do të marrim pjesën e dytë. Arkivi do të ketë dokumentimin në periudhën shqiptare nën sundimin osman”, deklaroi drejtori i Arkivave, Bido.